



**UDHËZUES PËR INFORMIM
ETIK DHE PROFESIONAL
PËR TEMA NGA
GJYQËSORI**



Shoqata e Gazetarëve
të Maqedonisë

SHKUP
2023

Ky publikim është pjesë e projektit rajonal *“Përforcimi i lirisë së mediave në Maqedoninë e Veriut”* i financuar nga Mbretëria e Holandës ndërsa i implementuar nga Komiteti Holandez i Helsinkit dhe Free Press Unlimited në partneritet me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë. Qëndrimet dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë tërësisht të autor/it(ëve). Të njëjtat nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e Mbretërisë së Holandës, e as të organizatave të cilat e zbatojnë projektin ose partnerit të tyre lokal.



Shoqata e Gazetarëve
të Maqedonisë



NETHERLANDS
HELSINKI
COMMITTEE

BUILDING AND SECURING
JUSTICE ACROSS EUROPE

FREE
PRESS
UNLIMITED

Impresum

Titulli

Udhëzues për informim etik dhe profesional për tema nga gjyqësori

Autorë

Mr. Llazar Sandev

Dr. Marina Tuneva

Bashkëpunëtor

Adrian Kerimi

Redaktor

Dragan Sekullovski

Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

Projekti

“Përforcimi i lirisë së mediave në Maqedoninë e Veriut”

Përkthimi në gjuhën shqipe

Leunora Kaliqi

Dizajni grafik

SHGM

Shkup, 2023

PËRMBAJTJA

PËR UDHËZUESIN	6
NGA PIKËPAMJA JONË – SI TË PËRMIRËSOHET INFORMIMI?	7
HYRJE DHE QËLLIMET E UDHËZUESIT PËR RAPORTIM PROFESIONAL TË MEDIAVE PËR GJYQËSORIN	11
PJESA 1 – VENDOSJA E GJYQËSORIT DHE TERMINOLOGJIA JURIDIKE	13
Hyrje në organizimin e gjykatave	14
Përkufizimi i termave në procedurën penale	20
Përkufizimi i termave në procedurën civile	25
Përkufizimi i termave në procedurën administrative	26
Procedura për miratimin e pranisë së gazetarëve në seancat publike	27
Shembuj për dallimet në përdorimin e terminologjisë juridike gjatë raportimit për seancat gjyqësore	29
PJESA 2 - UDHËZIMET DHE STANDARDET PËR INFORMIM PROFESIONAL NË FUSHËN E GJYQËSORIT	31
Saktësia, balancimi dhe gjithëpërfshirja në raportim	32
Përdorimi i fjalorit dhe terminologjisë së kuptueshme	34
Shmangia e sensacionalizmit në raportim	35
Prezumimi i pafajësisë	36
Mbrojtja e privatësisë	37
Mbrojtja e dëshmitarëve	40
Mbrojtja e privatësisë së të miturve	41
BIBLIOGRAFIA	43

PËR UDHËZUESIN

Dragan Sekullovski

Gazetarët luajnë rol kyç në formimin e opinionit publik ndërsa është e rëndësishme që ata të raportojnë në mënyrë të saktë dhe të paanshme për çështjet gjyqësore. Raportimi për gjyqësorin mund të jetë sfidues sepse kërkon kuptim të thellë të procedurave dhe proceseve ligjore. Mediat kanë përgjegjësi të raportojnë saktë dhe drejtë për proceset gjyqësore, pa ndikuar në rezultatin e rastit.

Prej këtu paraqitet nevoja për përgatitjen e Udhëzuesit praktik për raportim etik dhe profesional për gjyqësorin, e dedikuar për gazetarët dhe përfaqësuesit e gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut, por edhe për të gjitha palët tjera të interesuara që shprehin dëshirë të mësojnë për qasjen profesionale gjatë raportimit në këtë tematikë.

Udhëzuesi ofron një sërë parimesh dhe shembujsh të praktikave të mira që gazetarët duhet ti ndjekin gjatë raportimit për gjyqësorin. Në të përfshihen shumë tema kyçe siç janë, qasja deri te informacionet, besueshmëria, mbrojtja e të dhënave personale, parimi i prezumimit të pafajësisë dhe të drejtat e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor.

Gjithashtu, ky udhëzues i ofron përfaqësuesve gjyqësorë mënyrat se si ti komunikojnë me mediat informacionet në lidhje me procedurat gjyqësore, me qëllim të informimit në kohë dhe të saktë të publikut.

Shpresojmë se ky udhëzues praktik do të jetë në dobi të punëtorëve mediatik si dhe përfaqësuesve të gjyqësorit dhe i njëjti do të ndihmojë në kuptimin e përbashkët të principeve të raportimit etik dhe profesional, i cili do të garantojë që publiku të ketë qasje në informacione të sakta dhe të paanshme në lidhje me gjyqësorin.

NGA PIKËPAMJA JONË – SI TË PËRMIRËSOHET INFORMIMI?

Adrian Kerimi

Raportimi për proceset gjyqësore është një nga temat më të vështira që mund të mbulohet dhe ndiqet nga gazetarët. Jo për shkak të volumit të ngjarjes, por për shkak të përgjegjësisë se si një proces i ndjeshëm mund të përcillet në mënyrë transparente dhe të paanshme deri tek lexuesi (publiku).

Gjatë raportimit për një proces gjyqësor, gazetari medoemos duhet të ketë njohuri për proceset gjyqësore dhe natyrën e akteve penale ose civile duke përfshirë edhe fazat e gjykimit. Raportim mediatik për një proces gjyqësor nënkupton që gazetari duhet të jetë i njoftuar për shumë aspekte, që nga momenti se kur dhe në çfarë rrethanash ka ndodhur ngjarja, detaje rreth masave hetimore për të cilat publiku mund jetë i njoftuar si dhe rolin e Prokurorisë Publike në raste kur ka procedim penal.

Janë disa elemente thelbësore që një gazetar duhet të dijë përpara se të hyjë në sallën e gjyqit nga e cila duhet të raportojë, dhe atë:

- **Të ketë informacione** për palët dhe për kontekstin e përgjithshëm të rastit;
- **Të informohet** për procedurën e prokurorisë por edhe të gjykatës;
- **Të ketë njohuri** për procedurën civile gjegjësisht atë penale në përputhje me ligjet.

Është shumë e rëndësishme për gazetarin që të jetë i informuar për palët dhe kontestimin, për arsyen pse ndodhen aty, të ketë njohuri se kush është akuzuesi e kush i dyshuari dhe për çfarë, si dhe kush është viktimë, dëshmitari, cili është roli i ekspertëve të mundshëm, cili është roli i përfaqësuesve, kush e përfaqëson prokurorinë, mbrojtjen etj. Secila nga palët e kanë kuptimin dhe rolin e tyre gjatë procedurës por gazetari duhet të jetë në rrjedha me këtë sepse njohuritë do t'ia lehtësojnë jo vetëm ndjekjen por edhe raportimin për vetë procesin gjyqësor.

Procedurat e Prokurorisë Publike por edhe të Gjykatës janë të shumta, që nga procedura e hetimeve paraprake deri në ngritjen e aktakuzës por jo çdo fazë e procedurës është lajm. Në disa raste, aktivitetet ndoshta edhe duhet të mbrohen me qëllim që mos të ndërpritet procesi. Sigurisht që kjo varet edhe nga shkalla e interesit publik. Gazetari është i detyruar të informohet për: marrjen në pyetje të

të dyshuarve, dëgjimin e dëshmitarëve, provat e sekuestruara dhe masat e nevojshme mbrojtëse, varësisht nga vlerësimi i rrezikut. Duke ndjekur me kujdes këto veprime, gazetari do të jetë i informuar edhe për elementet e akuzës ndaj palëve.

Rregullat në gjykata mund të jenë të mërzitshme por ndjekja dhe respektimi i tyre mundëson që gjykimi të zhvillohet pandërprerë. Përpara se të hyjë në sallën e gjyqit dhe përpara se të pozicionohet në vendin e parashikuar për gazetarët dhe publikun, gazetari duhet të përgatitet që në emër të profesionit të mos abuzojë me asnjë ndjenjë emocionale të palëve dhe të mos e keqpërdor pozicionin e tij për të komprometuar seancën. Nuk lejohet asnjë përpjekje për të komunikuar me palët, për të reaguar me emocione apo për të nxitur të tjerët të reagojnë ose ndërmarrin veprime të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren e Punës të Gjykatave.

Fillimi i një procesi gjyqësor mund të mos ketë interes të konsiderueshëm mediatik, por ashtu siç zhvillohet procesi apo për arsye të ndryshme shtyhet disa herë radhazi, kjo duhet ta alarmojë gazetarin që ti ndjekë zhvillimet më me kujdes dhe të jetë në hap me kohën.

Gjatë raportimit është e domosdoshme që gazetari të kuptojë nivelin e gjyqimit apo fazën e gjyqimit. Kjo është shumë e rëndësishme sepse gazetari në një situatë të tillë do të informohet për zhvillimet aktuale dhe zhvillimet që pasojnë. Në shumë kronika të mediave, që i referohen një procedure gjyqësore, vërehet një dinamikë e caktuar gjatë raportimit. Në të shumtën e rasteve raportohet për të akuzuarit, veprën e tyre dhe zhvillimet e fundit, por jo gjithmonë theksohen veprimet konkrete, më në detaje për ngjarjen penale, shkallën e përgjegjësisë (i dyshuari kryesor, i dyshuari i dytë...), pasojat për palën tjetër ose buxhetin e shtetit (kur bëhet fjalë për shpërdorim të pozitës/detyrës zyrtare), statusin e Prokurorisë (parashtresat dhe propozimet) dhe pasojat ligjore në lidhje me akuzën dhe Kodin Penal.

Në shumë raporte mund të vërehet informacion subjektiv apo citimi i neneve të Kodit Penal apo Ligjit për Procedurë Penale, por pa shpjeguar kuptimin dhe sanksionimin e tyre. Gazetari është i obliguar ta informojë publikun për përmbajtjen e nenit për keqpërdorimin e detyrës zyrtare, nenin për vrasje, nenin për dhunë dhe nenet tjera, sepse duke i cituar ato vetëm me numra ashtu siç transmetohen nga Prokuroria Publike apo Ministria e Punëve të Brendshme gjatë dorëzimit të kallëzimit penal, nuk do të ketë informacion mjaftueshëm të qartë për publikun.

Gazetari nuk është gjyqtar por e mban të drejtën dhe është i detyruar t'ia shpjegojë publikut se çfarë ka ndodhur konkretisht në ngjarjen e cila është objekt i gjyqimit,

kush është i dyshuari kryesor dhe cila është piramida e përgjegjesisë, cila është përbërja e palëve (mbrojtësit dhe avokatët në cilësinë e përfaqësuesve ligjorë) ndaj akuzës së parashtruar nga Prokuroria Publike.

Gazetari gjatë raportimit duhet të ketë parasysh shqetësimin e familjarëve dhe emocionet e tyre. Dhimbja (emocioni) duhet çdoherë të respektohet dhe nuk duhet të keqpërdoret asnjë gjendje emocionale e momentit vetëm për lajm apo raportim atraktiv.

Nuk ka alfabet penal por njohja e gjuhës penale dhe e terminologjisë në gjyqësor e lehtëson punën e gazetarit dhe të lexuesit. Ndonëse është shumë e vështirë të përshtatet terminologjia gjyqësore në gjuhën e kuptuar nga publiku, gazetari është i detyruar të përdorë gjuhën penale për të respektuar raportimin objektiv.

Përderisa nuk është i njohur me terminologjinë, rekomandimi i duhur profesional është konsultimi me juristët dhe avokatët e përfshirë në proces. Në këtë mënyrë do ti ndihmohet që gazetari në të ardhmen të jetë i gatshëm të merret me këtë lloj të terminologjisë por edhe të raportojë në gjuhë thelbësore adekuate.

Tjetër element i rëndësishëm është njohja e Kodit Penal. Për fat të keq, Kodi Penal dhe Ligji për Procedurë Penale në vendin tonë mund të shkarkohen vetëm në gjuhën maqedonase, gjë që e vështirëson në mënyrë shtesë punën e gazetarëve shqiptarë gjatë raportimit dhe përshkrimin të dispozitave të Kodit Penal dhe Ligjit për Procedurë Penale. Përkthimi dhe përshtatja e tyre në gjuhën shqipe në veçanti do t'i ndihmonte mediat në gjuhën shqipe dhe gazetarët shqiptarë në shfaqjen më të madhe të interesit për procedurat gjyqësore dhe të mos ndiqet puna e gjykatës në bazë etnike (varësisht nga vepra penale).

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, si shoqatë e vetme në mbrojtje të gazetarëve në vend, kishte një rol konstruktiv për rritjen e transparencës përmes prisionit strategjik në gjykata dhe prokurori. Edhe pse suksesi është i pjesshëm, faji nuk qëndron tek SHGM por tek mentaliteti i cili duhet ndryshuar në gjykata dhe prokurori. Njashtu si gjyqtari edhe prokurori duhet të pranojnë se gazetari është pala që përfaqëson qytetarët dhe nuk duhet të injorohet apo pengohet gjatë kryerjes së detyrës.

Për të rritur transparencën në gjykata dhe prokurori, duke përfshirë këshillat e tyre (Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë), SHGM dhe dy organet kolektive të lartpërmendura duhet të përgatisin së bashku dokumentin e rekomanduar për raportim objektiv dhe përgjegjësi transparente. Kjo do të thotë se dokumenti

do të përfshinte standardet etike të gazetarit, të cilat është i detyruar t'i respektojë gjatë raportimit, si dhe dispozitat etike për domosdoshmërinë e transparencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjegjësisht gjykatave dhe Prokurorisë Publike.

Nevojitet një nismë e përbashkët për përkthimin dhe harmonizimin nga gjuha maqedonase në atë shqipe të: Kodit Penal, Ligjit për Procedurë Penale, Ligjit për Prokurori Publike, Ligjit për Gjykata, Ligjit për Këshillin Gjyqësor, Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publik, Dekreti për Punë në Gjykata, aktet nënligjore etj.

Në këtë mënyrë do të ndikohet në edukimin e gazetarëve gjatë raportimit, rëndësinë e tyre për thelbin e punës, ndërsa me njohjen e ligjit dhe dispozitave ligjore, krahas rritjes së cilësisë së raportimit do të rritet drejtpërdrejt transparenca në gjyqësor dhe në prokurorinë publike.

Në rritjen e transparencës gjithashtu do të ndikonte organizimi i punëtorive të përbashkëta për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të folurit publik dhe komunikimin me gazetarët, nga gazetarët dhe SHGM, në mënyrë që të mos mbetet e gjitha në kurriz të zëdhënësve ose zyrës së marrëdhënieve me publikun.

HYRJE DHE QËLLIMET E UDHËZUESIT PËR RAPORTIM PROFESIONAL TË MEDIAVE PËR GJYQËSORIN

Raportimi i mediave për tema që kanë të bëjnë me gjyqësorin dhe proceset gjyqësore është pjesë kyçe e funksionimit të parimit të drejtësisë së hapur. Publiku ka të drejtë të dijë se si funksionojnë gjykatat derisa besimi i publikut në drejtësi, ndër të tjera, varet nga ajo se sa respektohet transparencja nga ana e sistemit të drejtësisë. Publiku në proceset gjyqësore është kusht i domosdoshëm për transparencën dhe llogaridhënien e gjyqësorit¹. Gjykatat janë vende publike, por shumë pak qytetarë kanë mundësinë të ndjekin seancat gjyqësore dhe nga dora e parë të jenë dëshmitarë të ndodhive. Vetëm përmes hapjes, transparencës dhe komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të rregullt mes gjyqtarëve dhe gazetarëve do të rritet besimi i publikut tek gjyqësori². Pikërisht këtu del në pah rëndësia e profesionit të gazetarit. Mediat e afrojnë gjyqësorin me qytetarët, por janë edhe burimi kryesor i informimit dhe njohjes së publikut me çështjet që lidhen me gjyqësorin³.

Vetë mediat duhet të respektojnë disa rregulla dhe parime me të cilat do të shmangnin ndikimin e dëmshëm në proceset gjyqësore dhe rezultatet e tyre. Prandaj, raportimi i temave nga gjyqësori nënkupton njohje me rregulloren ligjore që i referohet gjyqësorit si dhe me parimet e standardet etike për informim profesional në këtë fushë.

Nga ana tjetër, gjyqtarët kanë nevojë që mediat ta vëzhgojnë drejtësinë në veprim dhe t'u mundësojnë qytetarëve të jenë të sigurt që ata po e përmbushin rolin e tyre në përputhje me Kushtetutën⁴. Në bazë të kësaj, mediat kanë nevojë për qasje të papenguar në gjykata. Mungesa e burimeve teknike dhe kapaciteteve hapësinore nuk duhet të përdoret si arsye për largimin e gazetarëve dhe mediave nga salla e gjyqit⁵. Nga ana tjetër, përgjigjet e pakta dhe të vonuara nga gjykatat kufizojnë mundësitë për informim serioz dhe objektiv. Një qasje e tillë len hapësirë për spekulime dhe supozime të cilat ndikojnë negativisht në informimin e publikut, por para së gjithash në punën profesionale të gazetarëve.

1 Dimovski S., Ilievski J., Dimitrievski Z. (2014) Publiku në procedurë penale - Udhëzues për gazetarët përmes procedurës penale. Misioni i OSBE-së në Shkup, <https://www.osce.org/files/f/documents/0/d/117927.pdf>

2 Pashoski, D. (2021) Studimi: Qëndrimet dhe perceptimet e gazetarëve për transparencën e gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, <https://znm.org.mk/analizi-i-publikaczi/>

3 Popçevski, K.Lj. (2017) Transparenca dhe hapja: modernizimi i sistemit gjyqësor në Republikën e Maqedonisë. Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Sudska-transparentnost_brief_Mreza23.PDF

4 Qendra për Kërkime dhe Analiza Ligjore (2019) Si të rritet transparencja dhe llogaridhënia në gjyqësor? - dokumenti i politikave publike, <https://bit.ly/3GP8xI9>

5 Ibid

Me qëllim të përmirësimit të transparencës në gjyqësor, në vendin tonë u formua Këshilli Gjyqësor Mediatik, i cili ndër të tjera ka për qëllim të merret me dezinformacionet gjatë raportimit për çështjet gjyqësore. Ky organ përpiqet të afirmojë transparencën gjyqësore, të rivendosë besimin në gjyqësor, të sigurojë qasje të pa-penguar të publikut në drejtësi dhe në këtë mënyrë të sigurojë mbrojtje juridike, paanshmëri dhe cilësi të drejtësisë për qytetarët⁶.

Bashkëpunimi korrekt dhe i vazhdueshëm mes gazetarëve dhe përfaqësuesve të sistemit të drejtësisë, me njohuri reciproke për nevojat profesionale të të dyja grupeve, do të mundësojë transmetimin e informacioneve të besueshme, të plota dhe në kohë tek qytetarët.

Prej këtu dalin edhe qëllimet themelore të këtij Udhëzuesi, respektivisht kontributi në punën profesionale të redaksive gjatë raportimit për temat nga fusha e sistemit të drejtësisë, duke përmirësuar kështu ndërgjegjësimin dhe njohjen e publikut me temat përkatëse për këtë fushë. Udhëzuesi përbëhet prej dy pjesëve ku e para përmban pasqyrë të sistemit gjyqësor dhe legjislacionit përkatës, përshkrimin e kompetencave të gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe vështrim mbi të terminologjinë juridike. Pjesa e dytë përmban udhëzime dhe standarde për informimin profesional të mediave për tema të fushës së gjyqësorit, të cilat mbështeten në udhëzime dhe rekomandime nga kodet etike, dokumentet dhe publikimet në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

⁶ Saiti, Xh., Koen, R. etj. (2020) Gjyqësori transparent: Doracak për gjyqtarë dhe gazetarë, Këshilli Gjyqësor-Mediatik pranë Shoqatës së gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3ir0Ecq>

PJESA 1

**VENDOSJA E GJYQËSORIT
DHE TERMINOLOGJIA
JURIDIKE**

Mr. Llazar Sandev

HYRJE NË ORGANIZIMIN E GJYKATAVE

Sistemi gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohet me Ligjin për gjykata, me të cilin organizohen Gjkata Themelore dhe Gjkata e Apelit, Gjkata Administrative dhe Gjkata e Lartë Administrative si gjykata të veçanta dhe Gjkata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më të lartë.

Në përgjithësi, gjykatat themelore ndahen në gjykata me juridiksion themelor dhe të zgjeruar sipas nenit 30 dhe 31 të Ligjit për Gjkata⁷.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kompetente për të vendosur në shkallë të parë **në bazë të veprave penale dhe kundërvajtjeve** janë gjykatat themelore me kompetenca themelore në fushat për të cilat janë themeluar, dhe kjo:

- **për veprat penale** për të cilat me ligj është përcaktuar si dënim kryesor, dënimi me burg deri në pesë vjet, nëse për vepra penale nuk është paraparë juridiksioni i një gjykate tjetër;
- **për veprat penale** për të cilat juridiksioni i gjykatës me kompetencë themelore është përcaktuar me ligj të veçantë,
- **për të gjitha llojet e veprave**, me përjashtim të veprave të cilat me ligj janë nën juridiksionin e një organi të administratës shtetërore, organizatës ose ndonjë organi tjetër që ushtron kompetencat publike, dhe
- **për ankesat** dhe parashtresat e procedurave për të cilat janë kompetente këto gjykata.

Gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, përveç juridiksionit të përcaktuar në nenin 30 të këtij ligji në sferat për të cilat janë themeluar, janë kompetente të vendosin në bazë të **veprave penale**, dhe atë:

- **për ata që ligji parashikon masën dënim** me burg mbi pesë vjet si dhe vepra penale dhe kundërvajtje të kryera nga fëmijët,
- **të veprave në bazë të lëndëve** për ekstradim, transferim të personave të dënuar, njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore,
- **në bazë të ankesave** dhe kundërshtimeve për procedurat për të cilat janë kompetente dhe
- **të vendosin** për procedurat e asistencës juridike ndërkombëtare të pëcaktuara me ligj

⁷ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/2019)

Në Gjykatën Themelore Penale të Shkupit është formuar një departament i specializuar gjyqësor për gjykimin e veprave nga sfera e krimit të organizuar dhe korrupsionit në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Departamenti i specializuar gjyqësor është kompetent të gjykojë për:

- **vepra penale të kryera nga një grup** i strukturuar prej tre ose më shumë personave, i cili ekziston për një periudhë të caktuar kohore dhe vepron me qëllim që të kryej një ose më shumë veprave penale për të cilat është përcaktuar dënim me burg për të paktën katër vjet, me qëllim që direkt ose indirekt të ketë përfitime financiare ose përfitime të tjera,
- **vepra penale të kryera nga një grup** i strukturuar ose organizatë kriminale në territorin e Republikës së Maqedonisë ose në shtete të tjera, apo kur vepra penale është përgatitur ose planifikuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtet tjetër;
- **vepra penale të kryera nga ndonjë nëpunës policor**, person zyrtar i autorizuar nga policia për siguri dhe kundërzbulim, pjesëtarë të policisë financiare, persona ligjërish të autorizuar në procedurë për kundërvajtje nga Drejtoria e Doganave, të cilët punojnë për zbulimin e veprave penale dhe personat e autorizuar të Ministrisë së Mbrojtjes të cilët punojnë për zbulimin dhe hetimin e veprave penale ose të pjesëtarëve të policisë së burgjeve gjatë kryerjes së ndonjë akti zyrtar apo vepra penale të kryera jashtë shërbimit profesional me përdorimin e kërcënimit serioz, forcës ose mjeteve të forta, të cilat si pasojë përfundojnë me vdekje, lëndime të rënda trupore, lëndime trupore, privimin e kundërligjshëm të lirisë, tortura dhe trajtime tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese dhe ndëshkimeve, nëse ligji parashikon ndjekje penale sipas detyrës zyrtare,
- **vepra penale për keqpërdorimin e pozitës** dhe autoritetit zyrtar nga neni 353 paragrafi 5, marrja e ryshfetit me vlerë të konsiderueshme nga neni 357 dhe ndërmjetësimi i kundërligjshëm nga neni 359 i Kodit Penal, të gjitha të kryera nga funksionarë të zgjedhur apo emëruar, person zyrtar ose përgjegjës në person juridik, dhe
- **vepra penale për prodhimin** dhe shitjen e paautorizuar të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 paragrafi 2, pastrimi i parave dhe produkteve të tjera për vepra penale me vlerë të konsiderueshme nga neni 273, kërcënimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313, dhënie e ryshfetit në vlera të mëdha nga neni 358, ndikimi i paligjshëm mbi dëshmitarët nga neni 368-a, shoqatë kriminale nga neni 394, organizata terroriste nga neni 394-a, terrorizmi nga neni 394-b, vepra penale të trafikimit të qenieve njerëzore nga neni 418-a, veprat penale të kontrabandës së migrantëve nga neni 418-b, trafikimit i të miturve nga neni 418-d dhe për vepra tjera kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare nga Kodi Penal, pavarësisht nga numri i autorëve të veprës.

Gjykatat themelore me kompetencë themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë në bazë të **kontesteve qytetare**, dhe atë:

- për kontestet pronësore-juridike dhe marrëdhëniet e tjera civile-juridike të personave fizik dhe juridik, vlera e të cilave është deri në 50.000 euro në kundërvlerë të denarëve, nëse me ligj nuk është paraparë juridiksioni i gjykatës tjetër;
- për kontestet rreth konstatimit dhe kontestimit të atësisë, amësisë, vërtetimit të ekzistencës së martesës, prishjen e martesës dhe shkurorëzimit,
- për dhënien ligjore të mbajtjes (alimentacionit),
- për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve,
- për pengim të posedimit,
- për mbajtjen e përjetshme,
- për kompensimin e dëmit që nuk kalon 50.000 euro në kundërvlerë të denarëve,
- në procedurat për sigurim dhe zbatim
- për marrëdhëniet e punës,
- në kontestet e marrëdhënieve trashëgimore-juridike,
- në çështjet jo-kontestimore dhe verifikuese, dhe
- për çështje të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjykatat themelore me kompetenca të zgjeruara, përveç juridiksioneve të lartë përmendura për fushat për të cilat janë themeluar, janë kompetente të vendosin për **punët civile dhe tregtare**, dhe atë:

- për kontestet pronësoro-juridike dhe marrëdhëniet tjera civilo-juridike të personave fizik dhe juridik, vlera e të cilave është mbi 50.000 euro në kundërvlerë në denarë, nëse me ligj nuk është paraparë juridiksioni i gjykatës tjetër;
- për kontestet tregtare, në të cilat të dyja palët janë persona juridik ose autoritete shtetërore, si dhe kontestet për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të si dhe të drejtat e pronësisë industriale,
- për procedurat e falimentimit dhe likuidimit,
- për kontestet për përcaktimin dhe sigurimin e ekzekutimit të detyruar, dhe
- për kontestet ndërmjet personave juridik vendas dhe subjekteve të huaja që rrjedhin nga marrëdhëniet e tyre të ndërsjella ekonomike, gjegjësisht tregtare.

Gjykatat e apelit janë kompetente:

1. të vendosin për ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore në zonën e tyre;
2. të vendosin për konflikt për kompetencë ndërmjet gjykatave të shkallës së parë në zonën e tyre, dhe
3. të kryejnë punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është kompetente:

1. të vendosë në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të saj kur është e përcaktuar me ligj;
2. të vendosë në shkallën e tretë dhe të fundit për ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit;
3. të vendosë mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të saj kur kjo është e përcaktuar me ligj;
4. të vendosë për konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatave themelore nga zona e gjykatave të ndryshme të apelit, konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatave të apelit, konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatës administrative dhe një gjykate tjetër, konfliktin e kompetencave ndërmjet Gjykatës së Lartë Administrative dhe një gjykate tjetër dhe të vendosë për transferimin e kompetencave territoriale të këtyre gjykatave;
5. të vendosë me kërkesë të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë për shkeljen e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me rregullat dhe parimet e themeluara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore dhe duke u nisur nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe
6. të kryejë punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Në literaturë dhe në ligje do të hasim edhe termat gjykatë e shkallës së parë, term që përdoret për gjykatat fillore dhe gjykatë e shkallës së dytë, term që përdoret për gjykatat e apelit.

Prokuroria Publike është autoritet shtetëror unik dhe i pavarur, i cili ndjek penalisht autorët e krimeve dhe veprave të tjera penale të përcaktuara me ligj dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me ligj. Shpesh do të dëgjoni se Prokuroria Publike i ndjek veprat penale sipas detyrës zyrtare. Kjo pasi Prokuroria Publike është kompetente për ndjekjen veprave penale për të cilat Kodi Penal nuk parashikon të ndiqen në bazë të padive private nga persona fizikë dhe juridikë.

Prokuroria Publike, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën e jetës private dhe dinjitetit, të drejtën për informim dhe lirinë e mediave, të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për mbrojtjen, integritetin, efikasitetin dhe konfidencialitetin e hetimeve, si dhe parimin e hapjes, informon publikun për rastet individuale mbi të cilat vepron dhe të cilat nxisin interes më të gjerë te publiku ose janë të rëndësishme për kryerjen e funksionit të tij.

Prokuroria Publike është e organizuar si Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokuroritë më të larta publike, prokuroritë publike themelore dhe Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut është themeluar Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimin të organizuar dhe korrupsionit. Në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit formohet një departament i specializuar për ndjekjen e veprave penale të kryera nga persona me kompetenca policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve. Departamenti i specializuar ka zyrën e ekspertëve dhe hetuesit e prokurorëve publik nga qendra hetimore në përputhje me këtë ligj. Prokurorët publik dhe udhëheqësi i departamentit të specializuar caktohen nga prokurori publik i Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, nga radhët e prokurorëve publikë të asaj prokurorie, me pëlqimin paraprak të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpesh në komunikim me publikun dhe në vetë procedurën penale përdoret shkurtesa PTHP dhe shtimi i qytetit përkatës (PTHP Shkup, PTHP Gostivar, PTHP Gjevgjeli etj.), që nuk është gabim të përdoret.

Këshilli i Prokurorëve Publikë është kompetent për:

- **ti dhënë mendim Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut** për propozimin, emërimin dhe shkarkimin e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- **zgjedh dhe shkarkon prokurorët publikë,**
- **cakton përfundimin e funksionit të Prokurorit Publik** dhe vendos në shkallë të dytë në procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve publik.
- **vendos për konstatimin e kryerjes joprofesionale** dhe të pakujdesshme të detyrës së Prokurorit Publik,
- **monitoron punën e prokurorëve publikë** në bazë të vlerësimit të punës së tyre në pajtim me Ligjin për Prokurorinë Publike,

- vendos për shkarkimin e përkohshëm nga pozita e Prokurorit Publik,
- vepron sipas parashtrësve dhe ankesave të qytetarëve dhe personave juridikë për punën e prokurorëve publik,
- vendos në bazë të kërkesës së parashtruar për përgjegjësi disiplinore të anëtarit të Këshillit,
- merr vendim për anëtarin e Këshillit që të mund të kontrollojë drejtpërdrejt punën e prokurorëve publik.
- miraton Kodin e Etikës për prokurorët publikë me propozim të Shoqatës së Prokurorëve Publikë.
- me vendim cakton numrin e prokurorëve publikë në prokuroritë publike.
- deri në fund të muajit shkurt të këtij viti, me vendim përcakton numrin e pozitave të lira të prokurorëve publikë në prokuroritë themelore publike për dy vitet e ardhshme dhe vendimin të dorëzojë në Akademinë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- shqyrton dhe vlerëson raportet vjetore të prokurorive publike,
- miraton Rregulloren e punës,
- merr vendim për pezullimin e funksionit të Prokurorit Publik,
- lëshon dhe heq kartat e identifikimit zyrtar të prokurorëve publikë,
- udhëheq listën personale të prokurorëve publikë,
- paraqet raport për punën e tij,
- jep mendime për ligjet nga sfera e fushëveprimit të punës së Këshillit,
- jep mendime për programet e Akademisë për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë,
- publikon shpallje dhe zhvillon procedurë për zgjedhjen e Prokurorit Publik për udhëzime të përkohshme në prokurori tjetër publike dhe
- kryen punë tjera të përcaktuara me ligj.

Qëllimi i këtij fjalori është të përafrohen termat juridik të cilat përdoren në proceset penale, civile dhe administrative.

PËRKUFIZIMI I TERMAVE NË PROCEDURËN PENALE

Procedura penale është e përcaktuar me Ligjin për procedurë penale (në tekstin e mëtejshëm LPP). Qëllimi i këtij ligji është që të mundësojë zhvillimin e drejtë të procedurës penale, në mënyrë që të mos dënohet asnjë i pafajshëm dhe autori i veprës penale të dënohet me sanksion penal në kushtet e parashikuara në Kodin Penal dhe në bazë të procedurës së zhvilluar ligjore.

Në vijim do të shënojmë termat që përdoren më së shumti gjatë informimit të publikut:

- ▶ **Kërkesë për rishikim të jashtëzakonshëm të aktvendimit të plotë** - mjet i jashtëzakonshëm juridik i cili dorëzohet nga ana e personit të dënuar ligjërisht ose avokatit të tij, kur gjykohet me dënim me burgim të pakushtëzuar ose me burgim për të mitur prej së paku 1 viti. Ai i dorëzohet Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila është gjykata kompetente e cila vendos në bazë të kësaj kërkesë.
- ▶ **Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë** - e njohur me emrin e shkurtuar **KML** - është mjet i jashtëzakonshëm juridik kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të parashtrojë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse shkelet Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, ligji ose marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. I dorëzohet Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- ▶ **Një ekspert ose këshilltar teknik** është personi që i posedon njohuritë e nevojshme profesionale dhe është i shënuar në regjistrin e personave të aftë pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- ▶ **Garancia** - depozitimi i parave të gatshme, letrave me vlerë, gjërave me vlerë ose objekteve tjera në lëvizje me vlerë të lartë që mund të shndërrohen lehtë në para dhe të ruhen, ose me detyrim personal të një ose më shumë qytetarëve që në rastet e arratisjes, përsëritjes, përfundimit ose kryerjes së veprës me të cilën kërcënohet i padituri, ato do të mbulojnë shumën e përcaktuar të garancisë. Me përjashtime, garancia mund të konsistojë edhe në vendosjen e hipotekës për shumën e garancisë së pasurisë së paluajtshme të personit që jep garancinë, e cila mund të konvertohet lehtësisht në para. Garancia në para të gatshme depozitohet në llogari të veçantë gjyqësore.
- ▶ **Viktimë e veprës penale** është çdo person që ka pësuar dëm i cili përfshin lën-

dim fizik ose mendor, vuajtje emocionale, humbje materiale, lëndime tjera apo kërcënim për të drejtat dhe interesat e tij si pasojë e veprës së kryer penale.

- ▶ **Ankesa** - mjet i rregullt juridik që parashtrohet nga palët që kontestojnë ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktvendimit të gjykatave themelore. Nëse vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit merr vendim në formë të aktgjykimit. Nëse anulohet vendimi i shkallës së parë, Gjykata e Apelit sjell aktgjykim në formë të vendimit.
- ▶ **LPP** - Ligji për procedurë penale
- ▶ **Procedura hetimore** është procedurë të cilën e fillon Prokurori Publik me marrjen e aktvendimit për hetim ndaj personit të caktuar kur ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer veprë penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare apo në bazë të propozimit.
- ▶ **Kërkesa pasurore-juridike** është dëmi i kërkuar nga i dëmtuari në procedurë e cila ka ndodhur si pasojë e veprës së kryer.
- ▶ **Prokurori Publik** - punonjës në Prokurorinë themelore apo të lartë publike ose në Prokurorinë themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- ▶ **Publik në procedurë** - Në përgjithësi publiku është i lejuar në procedurë. Kjo do të thotë që gazetarët mund të marrin pjesë në gjykime dhe të raportojnë për ato. Publiku mund të përjashtohet në bazë të mendimit të gjykatës apo me kërkesë të palëve ose të dëmtuarit, nëse kjo është e nevojshme për mbajtjen e sekretit shtetëror, ushtarak, zyrtar ose sekretit të rëndësishëm afarist, ruajtjen e rendit publik, mbrojtjen e jetës private të të akuzuarit, dëshmitarit apo të dëmtuarit, mbrojtjen e sigurisë së dëshmitarit apo viktimës dhe/apo mbrojtjen e interesave të të miturit.
- ▶ **Arrest i shtëpiak** - heqja e lirisë me urdhër për të mos dalë nga shtëpia deri në një fazë të caktuar të procedurës ose përderisa ekzistojnë arsyet për të cilat është shqiptuar e njëjta.
- ▶ **KP** - Kodi Penal
- ▶ **Masat për të siguruar prezencën e të akuzuarit** - masat që mund të ndërmerren ndaj të akuzuarit për sigurimin e prezencës së tij dhe mbarëvajtjen e pro-

cedurës penale si thirrja, masat paraprake, garancia, kapja, privimi i lirisë, arresti afatshkurtër, arresti shtëpiak dhe paraburgimi.

- ▶ **Masa paraprake** - 1) ndalesa për dalje jashtë vendit gjegjësisht vendbanimit; 2) obligimi i të pandehurit që herë pas here të paraqitet te zyrtari i përcaktuar ose në organin shtetëror kompetent; 3) marrja e përkohshme e dokumentit të udhëtimit ose ndonjë dokumenti tjetër për kalimin e kufirit shtetëror, përkatësisht ndalesë për dhënien e tij; 4) marrja e përkohshme e patentës së shoferit, përkatësisht ndalimi i dhënies së saj; 5) ndalesë për vizitën e një vendi apo zone të caktuar; 6) ndalesë për afrimin apo krijimin gjegjësisht mbajtjen e kontakteve ose marrëdhënieve me persona të caktuar dhe 7) ndalesë për ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara të punës që kanë të bëjnë me veprën penale.
- ▶ **Aktakuza** - pas përfundimit të procedurës hetimore kur Prokurori Publik konstaton se ka prova të mjaftueshme nga të cilat mund të vendos aktgjykimin e përgatit aktakuzën dhe ia dorëzon gjykatës kompetente. Përdorimi i termit aktakuzë kur informon publikun nuk është i gabuar (për shembull, Prokurori Publik ka ngritur aktakuzë kundër personit...)
- ▶ **I dyshuari** është personi ndaj të cilit zhvillohet procedura paraprake.
- ▶ **Bazat e dyshimit** janë të dhëna të cilat në bazë në njohurive dhe përvojës kriminalistike mund të vlerësohen si provë e veprës së kryer penale.
- ▶ **Dyshimi i bazuar** është shkallë më e lartë e dyshimit bazuar në provat e marra që sjellin në përfundimin se personi i caktuar ka kryer krim.
- ▶ **I akuzuari** është personi ndaj të cilit është vërtetuar aktakuza, është dorëzuar propozim aktakuza, është dorëzuar propozim për aplikimin e masës së sigurisë, është dorëzuar padi private ose është dorëzuar propozim për lëshimin e urdhrit për dënim.
- ▶ **I dëmtuari** - Krahas viktimës ekziston edhe një person tjetër të cilit me vepër penale dhe i cili merr pjesë në procedurë penale duke iu bashkangjitur ndjekjes penale ose me qëllim të realizimit të kërkesës pasurore-juridike i është cenuar apo kërcënuar e drejta personale apo pronësore. Kur me vepër penale është shkaktuar dëm në pronën shtetërore ose në buxhetin e saj atëherë Avokatura shtetërore vepron si përfaqësuese e shtetit.
- ▶ **I dënuari** është personi që me aktgjykim të formës së prerë është përcaktuar se është penalisht përgjegjës për një krim të caktuar.

- ▷ **Bastisje** është kontrollë e hollësishme e një personi, mjete transporti, shtëpie, në kushtet e përcaktuara me ligj.
- ▷ **Paraburgimi** - privimi i lirisë deri në një fazë të caktuar të procedurës ose derisa ekzistojnë arsyet për të cilat është shqiptuar.
- ▷ **Masat e posaçme hetimore:** përgjimi dhe regjistrimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike në procedurë të përcaktuar me ligj të veçantë; 2) monitorimi dhe regjistrimi në shtëpi, hapësirë të mbyllur ose të rrethuar që i takon asaj shtëpie, hapësirë afariste të shënuar si private ose në automatjet dhe hyrje në ato hapësira me qëllim të krijimit të kushteve për monitorimin e komunikimeve; 3) monitorimi dhe regjistrimi sekret i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose hapësirës afariste të shënuar si private; 4) inspektimi dhe kontrolli i fshehtë i sistemit kompjuterik; 5) kërkimi dhe krahasimi automatik ose në mënyrë tjetër i të dhënave personale; 6) inspektimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, 7) blerja e simuluar e artikujve; 8) dhënia dhe marrja e ryshfetit të simuluar; 9) dorëzimi dhe transportimi i kontrolluar i personave dhe sendeve si dhe prolongimi në kapjes ose konfiskimit të gjërave; 10) shfrytëzimi i personave me identitet të fshehur për regjistrimin, monitorimin dhe grumbullimin e informacioneve ose të dhënave për të depërtuar në grupe të organizuara kriminale; 11) hapja e një llogarie të simuluar bankare dhe 12) regjistrimi i simuluar i personave juridikë ose përdorimi i personave juridikë ekzistues për grumbullimin e të dhënave si dhe për të krijuar kushte për infiltrim.
- ▷ **Procedura paraprake** është procedurë në të cilën Prokurori Publik ndërmerr veprime të caktuara me qëllim të marrjes së provave materiale dhe verbale në bazë të të cilave do të vlerësojë nëse do të ngrit aktakuzë apo propozim aktakuzë në gjykatën kompetente.
- ▷ **Procedura para hetimore** është pjesë e procedurës dhe fazës së mëparshme në të cilën Prokurori Publik mbledh prova meqë ekziston bazë për dyshime nëse personi i caktuar ka kryer vepër penale.
- ▷ **Padia private** - mund të ngrihet nga cilido person fizik ose juridik për vepra penale për të cilat Kodi Penal parashikon se ndiqen me padi private.
- ▷ **Përfitimet nga veprat penale** - çdo pasuri ose të ardhura të përfituara drejtpërdrejt ose indirekt nga kryerja e veprës penale si dhe të përfitimet nga vepra penale e kryer jashtë vendit, me kusht që në kohën kur është kryer të konsidero-

het si vepër penale edhe sipas ligjeve të shtetit në të cilin është kryer si dhe sipas ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- ▶ **Aktgjykimi** - akti i gjykatës themelor me të cilin hidhet poshtë akuza ose lirohet nga akuza apo shpallet fajtor i akuzuari.
- ▶ **Plotfuqishmëria** - procedurë ligjërishit e plotfuqishme është kur palët i kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet e rregullta juridike dhe aktgjykimi i gjykatës themelore është vërtetuar nga Gjykata e Apelit.
- ▶ **Përsëritja e procedurës** - mjet i jashtëzakonshëm juridik që palët mund ta përdorin pasi procedura të ketë përfunduar ligjërishit (shih nenin 446 të Ligjit për procedurë penale).
- ▶ **Paditësi privat** është personi që ka ngritur padi private me qëllim të ndjekjes së veprave penale, që ndiqen me padi private dhe janë të parashikuara në Kodin Penal.
- ▶ **Prezumimi i pafajësisë** - personi i akuzuar për një krim do të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë.
- ▶ **Inspektimi i personave, automjeteve, bagazheve dhe ambienteve** është autorizim i bazuar në këtë ligj dhe një ligji tjetër, i kufizuar nga kontrollet e jashtme të veshjeve dhe gjërave tjera si dhe bagazheve, me anë të shqisave të të parit, dëgjimit dhe nuhatjes, por jo të veprimeve me të cilat diçka që nuk është e dukshme, bëhet e dukshme gjatë hapjes, zbërthimit dhe të ngjashme.
- ▶ **Aktvendimi** - akt i gjykatave themelore me të cilin merren vendime për çështje të caktuara gjatë procedurës për caktimin e paraburgimit, masave të sigurisë dhe çështjeve tjera në pajtim me Ligjin për procedurë penale.
- ▶ **Seanca** - dita që caktoi gjykata për paraqitjen e palëve në gjykatë që të diskutonjë mbi akuzën.
- ▶ **Palët në procedurë:** janë paditësi dhe i akuzuari.
- ▶ **Gjyqtar i procedurës paraprake** është gjykatësi i cili në procedurën paraprake vendos për liritë dhe të drejtat e të akuzuarit në rast të paraparë me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, me ligj dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe çështje të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

- ▶ **Dëshmitar** është personi i cili ka gjasa të jetë në gjendje të raportojë për veprën penale, autorin dhe rrethanat e tjera të rëndësishme.
- ▶ **Procedura e shkurtër** - për veprat penale që parashikohet gjobë apo masë burgimi deri në 5- pesë vjet. Procedura inicohet nga Prokurori Publik me ngritjen e aktakuzës ose nga paditësi privat me ngritjen e padisë private.
- ▶ **Paditësi** -Prokurori Publik dhe paditësi privat.
- ▶ **Këshilltarët teknikë** janë ekspertë nga regjistri i ekspertëve, të angazhuar nga palët kur kanë nevojë për ndihmën e ekspertëve nga një fushë e caktuar gjatë procedurës.

PËRKUFIZIMI I TERMAVE NË PROCEDURËN CIVILE

- ▶ **Ankesa** - mjet i rregullt juridik, të cilin palët e paraqesin kundër aktgjykimit të gjykatave themelore ose kundër vendimit të gjykatave themelore. Nëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet, Gjykata e Apelit merr vendim në formë të aktgjykimit. Nëse vendimi i shkallës së parë anulohet, Gjykata e Apelit merr vendim në formë të aktvendimi.
- ▶ **LPK** - Ligji për Procedurën Kontestimore.
- ▶ **Përgjigje ndaj padisë** - parashtresa me shkrim e dorëzuar nga i akuzuari në afatin e përcaktuar në përputhje me Ligjin për Procedurë Penale.
- ▶ **Aktgjykimi** - vendimi i gjykatës themelore me të cilin aprovohet ose refuzohet padia e të akuzuarit.
- ▶ **Përsëritja e procedurës** - mjet i jashtëzakonshëm juridik të cilin palët mund ta përdorin pasi të ketë përfunduar procedura ligjore dhe nëse janë plotësuar kushtet në Ligjin për procedurë penale.
- ▶ **Aktvendimi** - vendimi i gjykatës themelore e cila vendos për çështjet procedurale gjatë procedurës.
- ▶ **Revizioni** - mjet i jashtëzakonshëm juridik i cili mund të deklarohet në raste të jashtëzakonshme, gjegjësisht nëse pjesa e kontestuar e aktgjykimit tejkalon vlerën prej 1.000.000 denarëve dhe në rast të: 1) kontesteve për alimentacion; 2)

në kontestet lidhur me kompensimin për humbjen e alimentacionit për shkak të vdekjes së mbajtësit; 3) në kontestet e punës për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës; 4) në kontestet për të drejtën e autorit, përveç kërkesave monetare mbi atë bazë; 5) në mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përdorimin e shpikjeve dhe zhvillimeve teknike, mostrave, modeleve dhe markave tregtare dhe të drejtën për të përdorur një firmë apo emër si dhe në mosmarrëveshjet nga konkurrenca e pandershme dhe praktikat monopoliste me përjashtim të pretendimeve me para për këto arsye. dhe 6) në kontestet ku në procedurë ankimore, gjykata e shkallës së dytë e ka prishur aktgjykimin e shkallës së parë.

- ▶ **Seanca** - dita që gjykata e ka caktuar kur paditësi dhe i akuzuari me ftesë të gjykatës të vijnë për të diskutuar mbi akuzën e ngritur nga paditësi.
- ▶ **Palët në procedurë** - paditësi dhe i akuzuari.
- ▶ **Kontestet me vlerë të vogël** - janë konteste në të cilat padia ka të bëjë me kërkesën në të holla që nuk e kalon shumën prej 600.000 denarëve.
- ▶ **Padia** - akt fillestar me të cilën fillon një procedurë civile për mbrojtjen e të drejtave dhe detyrimeve.
- ▶ **Kërkesë paditëse ose petition** - kërkesë e cekur në padi me të cilën paditësi kërkon që gjykata atë ta miratojë dhe t' detyrojë të paditurin për veprime të caktuara.

PËRKUFIZIMI I TERMAVE NË PROCEDURËN ADMINISTRATIVE

- ▶ **Organi publik** përfaqëson ministritë, organet e administratës shtetërore, organizatat e themeluara me ligj, organet tjera shtetërore, personat juridikë dhe fizikë të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i pushteteve publike si dhe organet komunale në Qytetin e Shkupit dhe komunat tjera në qytetin e Shkupit;
- ▶ **Akti administrativ përfundimtar** është akti ndaj të cilit mund të fillohet konflikti në kontestin administrativ.
